



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 250 Prot.

Tiranë më 30. 7. 2015

PROCES-VERBAL

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së

Sot, në datën 30. 7. 2015 në orën 18:30, në ambientet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, u mbajt mbledhja e radhës e Bordit Mbikqyrës të AMSHC- së.

Rendi i ditës, sipas njoftimit paraprak të Kryetarit të Bordit parashikonte:

1. Raportimi i Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC- së për punën e kryer nga komisionet e vlerësimit të Thirrjes Nr. 8 dhe njohja me rezultatet paraprake të këtij procesi;
2. Diskutim rreth vlerësimit dhe përzgjedhjes së Projekt-Propozimeve të Thirrjes Nr.8 të paraqitura në relacionin shpjegues mbi dosjet e aplikimit dhe listen paraprake të propozuar nga komisioni i vlerësimit.
3. Përzgjedhja dhe shpallja e projekt propozimeve fituese të Thirrjes Nr.8;
4. Çështje të tjera.

Verifikohet prania e Drejtorit Ekzekutiv të AMSHC- së z. Andi KANANAJ, si edhe e anëtarëve të Bordit si më poshtë:

1. Z. Adrian THANO;
2. Znj. Majlinda DHUKA;
3. Znj. Gelardina PRODANI;
4. Z. Ismail ADEMI;
5. Znj. Kozara KATI;

Kryetari i BM, z. Thano, pasi verifikon se është plotësuar kuorimi i nevojshëm, deklaron të hapur mbledhjen në orë 18:30.

Menjëherë Kryetari i jep fjalën Drejtorit Ekzekutiv z. Kananaj i cili, pasi u uron mirëseradhnjen në AMSHC-së, realizon një përshkrim të shkurtër rreth punës së kryer nga komisionet e vlerësimit të Thirrjes Nr. 8 dhe bën njohjen me rezultatet paraprake të këtij procesi.

Drejtori Ekzekutiv i AMSHC- së mori fjalën duke u shprehur:

"Është ngritur grupi i punës kompetent për kryerjen dhe analizimin e dosjeve të subjekteve aplikues- pretendentë për përfitim të grantit duke nisur me inspektimin ligjor të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

dokumentacionit për të vijuar më tej me analizën narrative e së fundmi me kontrollin e buxhetit bazuar mbi shpërndarjen adekuate të zërave. Në vijim të kësaj situatë, është pregatitur materiali i tipit relacion lidhur me problematikat e hasura nga këqyrja e aplikimeve."

Anëtarëve të Bordit u shpërndahet një Relacion sqarues mbi dosjet e aplikimit nga subjektet rast pas rasti të thirrjes Nr. 8. Bashkëngjitur këtij relacioni gjendet edhe lista e Projekt-propozimeve të paraqitura nga OJF- të gjatë Thirrjes Nr.8 me pikëzimet dhe vlerësimet respektive të renditura sipas grupeve të përcaktuara të vlerësimit respektivisht grupi A, B, C dhe D. Pas një sërë diskutimesh dhe sugjerimesh vazhdoi edhe më tej shqyrtimi i listës së projekteve të vlerësuara nga grupi i vlerësimit të AMSHC.

Në përfundim të diskutimeve e vlerësimeve lidhur me Projekt-propozimet e mundshme për t'u shpallur fituese Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMSHC, z. A.Thano pyet: "A ka vërejtje dhe nevojë për diskutime të tjera lidhur me çështjen në fjalë?"

Pasi asnjë nga anëtarët e Bordit të pranishëm në mbledhje nuk shpreh vërejtje ose diskutim tjetër, Kryetari i Bordit z. Adrian Thano propozoi hapjen e votimit për miratimin e listës përfundimtare të projekt-propozimeve fituese të Thirrjes Nr. 8.

Pas procesit të votimit u miratimuan duke u shqyrtuar një për një projekt-propozimet e listës përfundimtare. Miratimi u bë në mënyrë unanime nga anëtarët e pranishëm të Bordit Mbikqyrës të AMSHC- së. (Tabela me listën e projekt-propozimeve të miratuara fituese të Thirrjes Nr. 8 i bashkëngjitet këtij procesverbal.)

Në vijim të mbledhjes u propozua nga Drejtori Ekzekutiv i AMSHC- së shpërnda një Relacion me objekt: "Për disa shtesa dhe ndryshime të Rregullores mbi Procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile" pas shpërndarjes së të cilës, Drejtori Ekzekutiv u shpreh: "Në kuadër të nevojës së paraqitur, ndryshimeve për efekt lehtësie të aplikimeve të subjekteve pretenduese për përfitim të granteve si dhe për efekt lehtësimi me qëllim shmangien e burokracisë, u pa e nevojshme ndërhyrja në Rregulloren e AMSHC- së sipas pikave të renditura në relacionin e shpërndarë."

Pas këtij komunikimi, anëtarët e pranishëm vijuan shqyrtimin e pikave të renditura duke diskutuar konkretisht në pikën 7, 8 dhe 9.

Znj. Dhuka vlerëson që në kuadër të pikës 8 të relacionit, të mund të ofrohen alternativa dhe sugjerime.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Drejtori Ekzekutiv shprehu shqetësimin lidhur me mosrespektim fakultativ të afatit të përfundimit të projektit (për shkak të shtyrjeve dhe shkurtimeve të afatit) duke propozuar nevojën për ndryshime të dispozitave kontraktore në të ardhmen. Ky shqetësim u shoqërua me propozimin e Drejtorit Ekzekutiv i cili u shpreh se gjatë muajit Shtator, specialistët e AMSHC- së do të dalin në terren në kuadër të monitorimit të projekteve. Mund të krijohet një praktikë e black- list- e për OJF- të jo korrekte dhe që nuk kanë mundur të justifikojnë fondin e përfituar.

Znj. Prodani mbështeti propozimin e Drejtorit Ekzekutiv duke shtuar se mund të ketë edhe forma të tjera të penalizimit si p.sh penalizimin për mos- lejim të aplikimit për një periudhë 5- vjeçare.

Znj. Dhuka shtoi se mund të shtojmë një penalizim shoqëruar me një afat kohor.

Në përfundim të diskutimit u sugjerua të realizohet një paketë propozimesh për parandalimin e këtyre situatave abuzive nga OJF-të e gatshme për mbledhjen e radhës.

Diskutimi vijoi me përpjekjen e kahershme lidhur me fuqizimin e AMShC- së, rritjen e reputacionit të saj dhe mundësitë e gjenerimit të fondeve.

Znj. Kati u shpreh: *"Duhet të realizohen takime me ambasadorë, donatorë etj. të cilëve t'u paraqitet një relacion/ memo përshkruese lidhur me panoramën e AMShC- së me qëllim krijimin e një reputacioni pozitiv të AMShC- së."*

Z. Ademi u shpreh se Burimet Njerëzore janë shumë të rëndësishme. Nevojitet përgatitje dhe trajnim i stafit për të krijuar një grup të fuqishëm pune i cili të ketë njohuri rreth donatorëve, mënyrës së shkrimit të projekt- propozimeve etj.

Znj. Dhuka u shpreh lidhur me mundësinë e gjenerimit të fondeve se ideja e saj ishte që AMShC- ja vetë të mund të krijojë një fondacion (OJF) i cili mund të hyjë në partneritet me donatorë të tjerë. Ky fondacion i themeluar nga AMShC-ja dhe i përkrahur fillimisht nga kjo e fundit, më vonë mund të gjenerojë vetë fonde duke qenë në pozicionin e grant- kërkuesit, ngritjes së partneriteteve, zhvillimit të aktiviteteve dhe konferencave të ndryshme duke promovuar në këtë mënyrë dhe ngritur pozitivisht reputacionin e AMShC- së.

Të gjithë anëtarët i shprehën dakort me këtë propozim duke shtuar se kjo do të ishte një mënyrë ideale për rritjen e reputacionit dhe fuqizimin e AMShC- së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Në përfundim të mbledhjes Kryetari i Bordit Mbikqyrës të AMShC- së përmbloodhi edhe njëherë vendimet e miratuara në këtë mbledhjesi më poshtë:

1. Përzgjedhjen dhe shpalljen e listës përfundimtare për projekt- propozimet fituese për Thirrjen 8;
2. Vendimi për shtyrjen e diskutimit dhe miratimit mbi Rregulloren për Financimin me Grant;

Të gjithë anëtarët e pranishëm aprovuan dhe firmosën në unanimitet për vendimet e propozuara.

Mbledhja u mbyll në orën 20: 00.

Anëtarët e Bordit Mbikqyrës firmosën si më poshtë vijon:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Adrian THANO

Kryetar i Bordit Mbikqyrës

Majlinda DHUKA

Nënkryetare e Bordit Mbikqyrës

Alban DUDUSHI

Anëtar

Albana Kociu

Anëtare

Aldo MERKOCI

Anëtar

Endri FUGA

Anëtar

Gelardina PRODANI

Anëtare

Ismail ADEMI

Anëtar

Kozara KATI

Anëtare

